

VENDIM
Nr.542, datë 12.8.2004

PËR STATUSIN E USHTARAKUT ME GRADË MADHORE TË FORCAVE TË
ARMATOSURA PAS DALJES NË LIRIM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 22 të ligjit nr.9171, datë 22.1.2004 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dorëzimi i detyrës së ushtarakut me gradë madhore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në çastin e daljes në lirim, të bëhet me ceremoni ushtarake, sipas rregullores së ceremonialit ushtarak.

2. Ushtaraku me gradë madhore përfiton, në çastin e daljes në lirim, një pagesë të menjëhershme, të barabartë me aq paga sa ka vite shërbimi në gradat madhore. Nëse vitet e shërbimit nuk janë të plota, shpërblimi të llogaritet në përpjestim me muajt që ka shërbyer.

3. Për efektet e këtij vendimi shpërblimi të llogaritet mbi pagën e fundit që ka pasur ish-ushtaraku me gradë madhore.

4. Kur paraqiten rrethana, që rrezikojnë jetën apo pronën e ish-ushtarakut me gradë madhore, në bazë të kërkesës së tij, i sigurohet ruajtja, për aq kohë sa ekziston ky rrezik.

5. Efektivi që merret me ruajtjen dhe sigurimin e ish-ushtarakut me gradë madhore, është pjesë e efektivit të batalionit të Policisë Ushtarake.

6. Në rastet e zhvillimit të ngjarjeve përkujtimore apo të ceremonive ushtarake, ftohet të marrë pjesë ish-ushtaraku me gradë madhore, i cili ka vendin e vet, të përcaktuar sipas rregullores së ceremonialit ushtarak. Ministria e Mbrojtjes përballon shpenzimet e nevojshme për pjesëmarrjen e tij në këto ceremoni.

7. Të drejtat e përcaktuara në këtë vendim përfitohen kur kohëzgjatja e qëndrimit në detyrë është jo më pak se një vit.

8. Në rastet e daljes në lirim sipas shkronjave “b” e “d” të pikës 1 të nenit 25 të ligjit nr.9171, datë 22.1.2004 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, ish-ushtaraku me gradë madhore nuk përfiton sipas këtij vendimi.

9. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimin i këtij vendimi, të planifikohen dhe të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

10. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.1.2005.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano